

Nr. Prot
(Lutemi referoni këtë numër në përgjigje)

Tiranë, më _____.____. 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Drejtuar: Operatorit Ekonomik: InfoSoft Office sh.p.k, NIPT J62426002Q me adresë,
Autostrada Tiranë – Durrës, km 8, Kashar, Tiranë, Shqipëri.

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: Mallra.

Lloji i Procedurës së prokurimit: Procedurë e hapur e thjeshtuar - mallra e ndarë në Lote.

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: **LOTI I: NR.REF- 66281-10-23-2025.**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje artikuj kancelarie”.**

Kohëzgjatja e kontratës: 2 (Dy) muaj për secilin lot.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: *Datë 24/10/2025.*

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: *Nr.63 datë 27/10/2025.*

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1) Operatori Ekonomik: LIBRARI DYRRAHU sh.p.k, NIPT L91418502J – me vlerë të ofertuar 2,378,676 (Dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH.

2) Operatori Ekonomik: MARKETING & DISTRIBUTION sh.p.k, NIPT J72124001N – me vlerë të ofertuar 2,574,210 (Dy milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e dhjetë) Lekë pa TVSH.

- 3) Operatori Ekonomik: OFFICE CENTER sh.p.k, NIPT K41425042N – me vlerë të ofertuar 2,822,500 (Dy milionë e tetëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH.
- 4) Operatori Ekonomik: InfoSoft Office sh.p.k, NIPT J62426002Q – me vlerë të ofertuar 3,299,900 (Tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH.
- 5) Operatori Ekonomik: IT Gjergji Kompjuter sh.p.k, NIPT K81503063B – me vlerë të ofertuar 3,517,000 (Tre milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik LIBRARI DYRRAHU sh.p.k, NIPT L91418502J – me vlerë të ofertuar 2,378,676 (Dy milionë e treqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) Lekë pa TVSH, pasi:

-OE ka paraqitur ofertë ekonomike anomalisht të ulët.

Në kundërshtim me pikën 5 të nenit 93 të LPP-së (i ndryshuar me LIGJ Nr. 16/2024 PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 162/2020 “PËR PROKURIMIN PUBLIK” , ku citohet, *Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.*”

2. Operatori Ekonomik MARKETING & DISTRIBUTION shpk, NIPT J72124001N - me vlerë të ofertuar 2,574,210 (Dy milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e dyqind e dhjetë) Lekë pa TVSH pasi:

-Nuk plotëson kriterin teknik, pika **2.3.5**, pasi nuk ka paraqitur mostrat për artikujt e kërkuar, sipas listës me numra rendor 4, 5, 9, 10, 11, 26, 30, 46 ditën e hapjes së kësaj procedure prokurimi. Referuar dokumenteve të tenderit si dhe njoftimit për ndryshimin e dokumenteve të tenderit citohet se *Mosparaqitja e të gjitha mostrave është kusht skualifikim.*

3. Operatori Ekonomik OFFICE CENTER sh.p.k, NIPT K41425042N - me vlerë të ofertuar 2,822,500 (Dy milionë e tetëqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) Lekë pa TVSH, pasi:

-Nuk plotëson kriterin teknik, pika **2.3.3**, pasi skeda teknike kërkesë e këtij kriteri e paraqitur nga OE nuk është në përputhje me pikën 4.5 të Njoftimit të Kontratës ku përcaktohet se gjuha e hartimit të ofertës është gjuha shqipe. Skeda teknike e paraqitur është në gjuhën angleze.

-Nuk plotëson shtojcën 3, pasi nuk është ofertuar për zërin nr.20 në përputhje me njoftimin për ndryshimin e dokumenteve të tenderit ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

4. Operatori Ekonomik IT Gjergji Kompjuter sh.p.k, NIPT K81503063B - me vlerë të ofertuar 3,517,000 (Tre milionë e pesëqind e shtatëmbëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, pasi:

-Nuk plotëson kriterin teknik, pika **2.3.1** pasi OE ka paraqitur përvojë të mëparshme në vlerë më të vogël se vlera e kërkuar në këtë kriter. Vlera e kërkuar është 1,401,564.45 lekë ndërkohë që përvoja e paraqitur është 1,103,292 lekë.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik InfoSoft Office sh.p.k, NIPT J62426002Q me adresë, Autostrada Tiranë – Durrës, km 8, Kashar, Tirane, Shqipëri, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 3,299,900 (Tre milionë e dyqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind) Lekë pa TVSH është identifikuar si ofertues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Viola Haxhiademi